



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:267945

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05528505

C.nr.4631/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoren profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.S.Sh. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë av. D.Sh. dhe N.M. nga Prizreni, kundër të paditurës AAPARr - Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 110.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.S.Sh. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura AAAPARr - Prishtinë, në emër të shujtave ditore për 55 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën prej datës 11.06.2022 deri më datën 21.11.2022), t'i kompensoj shumën e përgjithshme prej 110.00 (njëqind e njëmbëdhjetë) euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 29.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E.S.Sh. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së saj av. N.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës AAPARr - Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 110.00 euro.

E autorizuar e paditëses në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi" Prizren, ku e njëjta gjatë vitit 2022 nga data 11.06.2022 deri më datë 21.11.2022 ka gjithsej 55 ditë pune. Ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shujtat ditore nga 2 euro për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar. Ka shtuar se është me rëndësi të theksohet se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë më datë 21.11.2022 është tërhequr nga Kontrata Kolektive e Arsimit nr.01B/105 të datë 21.01.2021 dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të zbatohet. Po ashtu, kërkesa e paditëses është parashkruar bazuar në nenin 341 të LMD-së dhe padia është në kundërshtim me nenin 253 të LPK-së, pasi që i mungojnë faktet mbi të cilat paditësja e mbështetë padinë. Andaj duke pasur parasysh thëniet e cekura si më lartë i ka propozuar gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër reference 1318/23 i datës 30.10.2023, të lëshuar nga administratori i Qendrës së Kompetencës “11 Marsi” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Elda Susuri-Shehu, është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe e njëjta nga data 11.06.2022 deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 55 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj pasi që vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës, konkretisht paditësja Elda Susuri-Shehu, është në marrëdhënie pune në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren dhe për vitin 2022, nga data 11.06.2022 deri me datë 21.11.2022, ka gjithsej 55 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrajt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar

seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësja E.S.Sh. për vitin 2022, nga data 11.06.2022 deri më datë 21.11.2022, ka realizuar gjithsej 55 ditë pune e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 110.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 55 me 2 euro (55 x 2 euro = 110.00 euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (29.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me prapësimin e të paditurës se kërkesa e paditëses është parashkruar, gjykata vlerësoi se një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar. Kështu, kërkesa e paditëses është bërë e arritshme nga data 12.06.2022 deri më 22.11.2022, ndërsa sipas nenit 87 të Ligjit të Punës përcaktohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë e ka parashtruar në gjykatë më datë 29.11.2023, pra më shumë se një vit nga dita kur i është bërë e arritshme kërkesa e saj. Rrjedhimisht, me parashtrimit e padisë në gjykatë, pala paditëse ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe nuk ka arritur parashkrimi i kërkesës për kompensimin e shujtave ditore.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4631/2023, datë 29.03.2024

G j y q t a r i
Uran Zogaj

Numri i lëndës: 2023:267945
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05528505

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate Themelore.